



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 01/83
Datë: 25.09.2009

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, si dhe të nenit 4 paragrafi (3) të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 25 shtator 2009, mori

V E N D I M

1. Miratohet ekstrakti i procesverbalit dhe transkripti nga mbledhja e 82 e Qeverisë së Republikës së Kosovës.
2. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.


Hashim THAÇI
Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 02/83
Datë: 25.09.2009

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, si dhe nenit 4 pika 3 të Rregullores së Punës të Qeverisë së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës në mbledhjen e mbajtur më 25 shtator 2009, mori

V E N D I M

1. Miratohet Strategjia e Minerare e Republikës së Kosovës për periudhën 2010 - 2025.
2. Ngarkohet Ministria e Energjisë dhe Minierave për zbatimin e këtij vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.


Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 03/83

Datë: 25.09.2009

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 16 të Ligjit për Aviacionin Civil Nr. 03/L - 051, si dhe të nenit 4 paragrafi (3) të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 25 shtator 2009, mori

V E N D I M

PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E VENDIMIT TË QEVERISË NR. 04/71, TË DATËS
03.07.2009.

1. Ndryshohet dhe plotësohet vendimi i Qeverisë Nr. 04/71, i datës 03.07.2009.
2. Pika 1. d) e vendimit Nr. 04/71, ndryshohet si në vijim:
 - a) Fuad Ramiqi - anëtar, zëvendësohet me, Kosum Kosumi - anëtar.
3. Obligohet Ministria e Transportit dhe Postë-Telekomunikacionit për zbatimin e këtij vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 04/83

Datë: 25.09.2009

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 11 paragrafi (2.4) të Ligjit mbi Partneritetet Publiko-Private dhe Koncesionet në Infrastrukturë dhe Procedurat për Dhënie të Tyre Nr. 03/L- 090, si dhe të nenit 4 paragrafi (3) të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 25 shtator 2009, mori

V E N D I M

1. Z. Bekim Çollaku emërohet përfaqësues i Zyrës së Kryeministrit, në Komisionin Drejtues Ndërmëntor për Partneritet Publiko-Privat.
2. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 05/83
Datë: 25.09.2009

Në mbështetje të nenit 92 pika 4, dhe nenit 93 pika 4, të Kushtetutës të Republikës së Kosovës, si dhe të nenit 4, pika 3 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 25 shtator 2009, mori

V E N D I M

1. Për përmbushjen e kontributit vjetor të Qeverisë së Republikës së Kosovës në Këshillin për Bashkëpunim Rajonal, me seli në Sarajevë, respektivisht në buxhetin e Sekretariatit të Këshillit për Bashkëpunim Rajonal (RCC), ndahen mjete financiare për vitin 2009 në vlerë prej 40.000 (dyzetmijë) euro.
2. Shuma në vlerën e sipërpërmendur është formalisht e vendosur në Takimin e Tryezës Rajonale të Paktit të Stabilitetit për Evropën Juglindore në Bukuresht, nëntor 2006, në bazë të kontributit të dakorduar vjetor, varësisht prej grupit (Republika e Kosovës bën pjesë në grupin prej 4 % të shumës totale) të vendeve të Evropës Juglindore.
3. Mjetet financiare nga pika 1. e këtij vendimi sigurohen nga Programi Shpenzimet e Paparashikuara, kategoria e ekonomike, Rezervat.
4. Obligohet Ministria e Ekonomisë dhe Financave dhe Zyra e Këshilli për Bashkëpunim Rajonal në Zyrën e Kryeministrit për zbatimin e këtij vendimi.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë




Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 06/83
Datë: 25.09.2009

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 115 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme Nr. 03/L-073, si dhe të nenit 4 paragrafi (3) të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 25 shtator 2009, mori

V E N D I M

1. Aprovohet Plani i Buxhetit për vitin 2009 për Komisionin Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës në shumën prej 197.384 (njëqindëntëdhjetë e shtatë mijë e treqindëtetëdhjetë e katër) euro.
2. Mjetet financiare sipas pikës 1. të këtij vendimi sigurohen nga Shpenzimet e Paparashikuara, kodi organizativ 232, kategoria ekonomike - Rezerva.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Ministria e Ekonomisë dhe Financave dhe Komisioni Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.


Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 07/83
Datë: 25.09.2009

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, si dhe të nenit 4 paragrafi (3) të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 25 shtator 2009, mori

V E N D I M

1. Miratohet Projektligji për Domenin Shtetëror.
2. Obligohet Sekretari i Përhershëm i Zyrës së Kryeministrit që projektligjin nga pika 1. e këtij vendimi t'ia procedojë për shqyrtim dhe miratim Kuvendit të Kosovës.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 08/83
Datë: 25.09.2009

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, si dhe të nenit 4 paragrafi (3) të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 25 shtator 2009, mori

V E N D I M

1. Miratohet Projektligji për Borxhin Publik.
2. Obligohet Sekretari i Përhershëm i Zyrës së Kryeministrit që projektligjin nga pika 1. e këtij vendimi t'ia procedojë për shqyrtim dhe miratim Kuvendit të Kosovës.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë